

Aspekte praktike të zbatimit të Rregullores

“Mbi krijimin e një Procedure Europiane për Paditë e Vogla”

21.02.2021

## **Rasti Studimor 1: “Ndërhyrësi” (GJED C-627/17)**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Faktet:**

ZSE Energia a.s., e themeluar në Bratislavë (Republika Sllovake), operon një kompani të furnizimit me energji dhe kishte lidhur një kontratë furnizimi me energji me Z. R, një qytetar italian me vendbanim në Graz, Austri. ZSE Energia a.s. është e mendimit se R nuk ka përmbushur detyrimet e tij kontraktuale dhe synon të ngrejë një padi duke kërkuar vlerën 423.74 EUR, plus interesin e pagesës së vonuar, në përputhje me Rregulloren e Procedurës Europiane të Padive të Vogla Nr. 861/2007 (në vijim: Rregullorja ESCP).

- **Pyetja 1:** Cila gjykatë ka juridiksion ndërkombëtar?
- **Pyetja 2:** A bie kjo çështje në fushën e zbatimit të Rregullores ESCP?
- **Pyetja 3:** Çfarë kërkesash formale duhet të marrë parasysh paditësi kur paraqet kërkesëpadinë e tij?

## Rasti Studimor 1: “Ndërhyrësi” (GJED C-627/17)

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari I:**

Z. R, i padituri, nuk është me vendbanim në Austri, por në Republikën Sllovaqe; ZSE Energia a.s. dhe gjykata e investuar gjithashtu kanë selinë në Republikën Sllovaqe. ZSE Energia a.s. paraqiti kërkesën e tij në gjykatë duke përdorur Formularin A në Shtojcën I duke identifikuar veten si “Paditësi 1”. Gjithashtu, në atë formular, ZSE Energia CZ, s.r.o., themeluar në Republikën Çeke, u identifikua si “Paditësi 2”. ZSE Energia CZ, s.r.o. i pohoi gjykatës, në një dokument të veçantë të bashkangjitur në formularin e padisë, se ajo po merr pjesë si një “ndërhyrës”, pasi ajo ka një interes ligjor në përfundimin e procesit.

*Shënim: Në ligjin slloëak, një “ndërhyrës” përcaktohet në Paragrafin 81 të Kodit të Procedurave Kontestimore Civile si një person i cili merr pjesë në proces së bashku me kërkuësin ose të paditurin dhe ka një interes ligjor në përfundimin e procesit.*

- **Pyetja 4:** Si duhet të veprojë gjykata nëse, sipas informacionit në Formularin A, padia duhet të zgjidhet vetëm kundër ZSE Energia a.s. si “Paditësi 1”, por aplikimi aktual përmban informacione në lidhje me dy paditësa?

## **Rasti Studimor 1: “Ndërhyrësi” (GJED C-627/17)**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari II:**

Në përgjigje të asaj kërkesë, ZSE Energia a.s. paraqiti një formular të korigjuar siç duhet në gjykatë ku përmendi vetëm ZSE Energia a.s. si “Paditës” ndërsa ZSE Energia CZ, s.r.o. ishte renditur vetëm si një “Ndërhyrës”.

- **Pyetja 5:** A bie në fushën e zbatimit të Rregullores ESCP në bazë të Nenit 2 (1) (së bashku me Nenin 3 (1) të Rregullores ESCP), një procedurë e filluar duke përdorur Formularin A ndërmjet një paditësi (kërkuesi) dhe një të padituri nëse palët janë me vendbanim në të njëjtin Shtet Anëtar me Shtetin Anëtar në të cilin ndodhet gjykata ose tribunali i investuar dhe vetëm “ndërhyrësi” është me vendbanim në një Shtet Anëtar tjetër?
- **Pyetja 6:** Si duhet të veprojë gjykata nëse padia nuk bie në fushën e zbatimit të Rregullores ESCP?

•

# Rasti Studimor 2: Degustimi i verës

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

## **Faktet:**

Znj. A (me vendbanim në Vjenë) i kalon pushimet verore në Torbole (Itali) dhe rezervon një degustim vere me kompaninë Vino-S.r.l. (themeluar në Torbole, Itali). Për shkak se në fund të degustimit Znj. A arrin në përfundimin se vështirë se ndonjë prej verërave ishte e këndshme, ajo largohet nga kantina e verës pa paguar. Vino-S.r.l. tani kërkon pagesën prej 330,00 EUR plus kamatë për pagesë të vonuara nga Znj. A dhe fillon Procedurën Europiane të Padive të Vogla në datën 14.10.2020 me anë të Formularit A, i cili dërgohet në gjykatën kompetente në Vjenë.

- **Pyetja 1:** Cilat kërkesa formale duhet të marrë parasysh gjykata pasi të marrë formularin e padisë?

## **Rasti Studimor 2: Degustimi i verës**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari I:**

Znj. A kërkon zhvillimin e një seance verbale.

- **Pyetja 2:** A është e detyruar gjykata të caktojë një seancë verbale?

## **Rasti Studimor 2: Degustimi i verës**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari II:**

Znj. A i dorëzohet Formulari standard C i përgjigjes së gjykatës, më 27.10.2020. Për shkak se për momentin ajo është shumë e ngarkuar me punë, e shtyn përgjigjen ndaj Formularit C. Vetëm në datën 7.12.2020 ajo e plotëson atë dhe e kthen në gjykatën kompetente.

- **Pyetja 3:** Si do të veprojë gjykata pasi të ketë kaluar afati 30-ditor?
- **Pyetja 4:** A ka i padituri mundësinë e ankimit kundër vendimit në mungesë?

## **Rasti Studimor 2: Degustimi i verës**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari III:**

Znj. A i dorëzohet Formulari standard C i përgjigjes së gjykatës, më 27.10.2020. Për shkak se ajo është shtruar në spital për dy muaj për shkak të një aksidenti, ajo nuk mëson për vendimin në mungesë të dhënë më 24.11.2021 deri në ditën kur del nga spitali, 3.1.2021.

- **Pyetja 5:** A ka i padituri një mundësi për të ankimumar vendimin në mungesë?



## **Rasti Studimor 3: Fusha e zbatimit të Procedurës Europiane të Padive të Vogla**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Rijekës: Ivana Kunda dhe Danijela Vrbljanac*

### **Faktet:**

Z. Martič është një shtetas slloven, me vendbanim dhe vendqëndrim të zakonshëm në Maribor, Slloveni. Në gusht 2017, ai u ndesh me faqen e internetit të një kompanie Homeostasis d.o.o. me selinë e saj të regjistruar në Rijeka, Kroaci, e cila ofronte produkte të ndryshme për shëndetin për përdorim shtëpiak. Ai urdhëroi një pajisje portative oksigjeni për përdorim shtëpiak të prodhuar nga prodhuesi i mirënjohur Life balance d.o.o. me seli të regjistruar në Pula, Kroaci. Ai pagoi çmimin prej 2.340 EUR përmes internet-banking dhe pas 2 javësh, ai e mori pajisjen. Sidoqoftë, pajisja nuk funksionoi si duhet. Në tetor 2017, z. Martič vendos të padisë përpara gjykatës sllovene.

## **Rasti Studimor 3: Fusha e zbatimit të Procedurës Europiane të Padive të Vogla**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Rijekës: Ivana Kunda dhe Danijela Vrbljanac*

- **Pyetja 1:** Duke marrë parasysh llojin e pretendimit, a mundet Z. Martič të kërkojë një zëvendësim të pajisjes nga Homeostasis d.o.o. duke u mbështetur proceduralisht në dispozitat e Rregullores për Procedurën Europiane të Padive të Vogla (ESCP)?
- **Pyetja 2:** A do të ishte ende e zbatueshme Rregullorja ESCP nëse rrethanat faktike do të ndodhnin një vit më parë dhe Z. Martič vendos të padisë në tetor 2016?
- **Pyetja 3:** Imagjinoni sikur Z. Martič të ketë porositur produktin nga Homeostasis Slovenia d.o.o. me selinë e saj qendrore në Lubjanë, një filial (shoqëri bijë) i kompanisë kroate Homeostasis d.o.o. Në procedurat e filluara nga Z. Martič kundër Homeostasis Slovenia d.o.o., Homeostasis d.o.o. paraqitet si ndërhyrës. A do të ishte në gjendje Z. Martič të kërkonte zëvendësimin e pajisjes nga Homeostasis d.o.o. Slovenia duke u mbështetur proceduralisht në dispozitat e Rregullores ESCP?
- **Pyetja 4:** Nëse z. Martič vendos të padisë prodhuesin e pajisjes, kompania Life Balance d.o.o. për dëmet, a mund ta bëjë ai duke u mbështetur në dispozitat e Rregullores së ESCP?

## **Rasti Studimor 4: Procedura Europiane e Padive të Vogla dhe Juriksioni Ndërkombëtar**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Rijekës: Ivana Kunda, Danijela Vrbljanac dhe Martina Tičić*

### **Faktet:**

Sala de Arte S.L. është një shoqëri spanjolle, e vendosur në Valencia, Spanjë, duke shitur vepra arti si piktura dhe vazo. Blerësit e shoqërisë gjenden në të gjithë Evropën. Zonja Novak, një grua biznesi kroate u ndesh me reklamën e Sala de Artes S.L. në një nga revistat kroate për dizajnin e brendshëm. Në maj të vitit 2020, pasi znj. Novak e kontaktoi atë, shoqëria lidhi një kontratë me znj. Novak dhe i dha asaj shtatë vepra arti. Veprat e artit u dorëzuan në Rijeka dhe çmimi i tyre i përgjithshëm arriti në 1,200 euro. Kontrata deklaroi se afati i fundit i pagesës është 25 qershor 2020. Meqenëse znj. Novak nuk e pagoi çmimin edhe pas kërkesave dhe paralajmërimeve shtesë, shoqëria vendosi të fillojë Procedurën Europiane të Padive të Vogla (ESCP) në Spanjë.

## **Rasti Studimor 4: Procedura Europiane e Padive të Vogla dhe Juriksioni Ndërkombëtar**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Rijekës: Ivana Kunda, Danijela Vrbljanac dhe Martina Tičić*

### **Skenari I:**

Veprat e artit ishin menduar për kafenenë e zonjës Novak të vendosur në Rijeka, ku ajo banon.

**Pyetja 1:** A kanë juridiksion gjykatat spanjolle për të zgjidhur çështjen?

### **Skenari IIA:**

Znj. Novak porositi veprat e artit për shtëpinë familjare në Rijeka.

**Pyetja 2:** A kanë juridiksion gjykatat spanjolle të zgjidhin çështjen?

## **Rasti Studimor 4: Procedura Europiane e Padive të Vogla dhe Juriksioni Ndërkombëtar**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Rijekës: Ivana Kunda, Danijela Vrbljanac dhe Martina Tičić*

### **Skenari IIB:**

Zonja Novak porositi veprat e artit për shtëpinë e saj familjare në Rijeka. Kur gjykata Spanjolle i dorëzoi asaj kopjen e formularit të padisë, dokumentet mbështetëse dhe formularin e përgjigjes, ajo paraqiti përgjigjen e saj duke deklaruar se nuk ishte e kënaqur me veprat e artit që iu dhanë pasi ishin të ndryshme nga ato që ajo pa në faqen e internetit të shoqërisë. Sidoqoftë, ajo nuk e kundërshtoi juridiksionin e gjykatës spanjolle.

**Pyetja 3:** A kanë juridiksion gjykatat spanjolle për të vendosur mbi çështjen?

## **Rasti Studimor 5: Blerësi online (Neni 6 ESCP; GJED C-14/07)**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Faktet:**

Mateja (M) jeton në Bleiburg (Austri) dhe bëri blerje të shumta përmes internetit gjatë izolimit për shkak të krizës së Coronas në Mars 2020. Ndër të tjera, ajo bleu një biçikletë mali për 1,400 EUR nga kompania Sllovene Dravabike d.o.o. (D) dhe pajisje zhytjeje për 800 EUR nga Splitdive Kroate d.d. (S). Të dy kompanitë kanë dorëzuar në kohë, por M nuk paguan sepse ajo beson se ajo ka marrë produkte inferiore. Si D ashtu edhe S fillojnë një Proces Europian të Padive të Vogla përmes formularit standard të padisë A; D paraqet formularin e padisë në gjuhën sllovene, S në gjuhën kroate. Si një karintiane-sllovene, M flet gjermanisht dhe sllovenisht, ku aftësitë e saj në gjuhën sllovene janë afërsisht në nivelin B2; M e kupton kroatishten (BCS) në nivelin A2. Në Gjykatën e Rrethit Bleiburg, proceset mund të zhvillohen në gjuhën gjermane si dhe në gjuhën sllovene.

- **Pyetja 1:** Cila gjykatë ka juridiksion për këto dy padi të vogla?
- **Pyetja 2:** Si duhet t'i trajtojë Gjykata e Rrethit Bleiburg formularët e padive?

## **Rasti Studimor 5: Blerësi online (Neni 6 ESCP; GJED C-14/07)**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari I:**

Kontrata midis M dhe S u lidh në gjuhën kroate, gjithashtu GTC (termat dhe kushtet e përgjithshme) të S janë të aksesueshme vetëm në gjuhën kroate në internet. S i bashkëngjiti padisë marrëveshjen e blerjes dhe GTC vetëm në gjuhën kroate. Gjykatësi kompetent, Gjykata e Rrethit në Bleiburg flet rrjedhshëm gjuhën Kroate. S ka korigjuar formularin e padisë në përputhje me udhëzimet e gjykatës (paraqitja në gjuhën Sllovene).

- **Pyetja 3:** Si duhet ti trajtojë gjykata provat në gjuhën kroate?
- **Pyetja 4:** A mundet M të refuzojë të pranojë dokumentet që bashkërisht i janë dorëzuar asaj (Formulari A i padisë në gjuhën sllovene, si dhe kontrata dhe GTC në gjuhën kroate) në procesin kundër S?

## **Rasti Studimor 5: Blerësi online (Neni 6 ESCP; GJED C-14/07)**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit*

### **Skenari II:**

Vetë M nuk jeton në Bleiburg por në Vjenë. Ajo bleu biçikletën malore dhe pajisjet e zhytjes për motrën e saj Ana (A) e cila jeton në Bleiburg dhe gjithashtu i është dorëzuar atje. As sllovenishtja dhe as kroatishja nuk janë gjuhë zyrtare në Vjenë. Kontrata midis M dhe D u lidh në gjuhën sllovene, gjithashtu GTC e S janë të aksesueshme vetëm në gjuhën sllovene në Internet.

- **Pyetja 5:** A mundet M të refuzojë të pranojë formularin e padisë që i është dorëzuar asaj - tani në Vjenë - në procesin kundër D?
- **Pyetja 6:** Si duhet të veprojë gjykata në Bleiburg nëse D refuzon të pranojë dokumentet?



## **Rasti Studimor 6: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Faktet**

Bea, një shtetase gjermane, rezervon për të dhe familjen e saj, të përbërë nga shtatë vetë, një fluturim me Alitalia nga Frankfurti në Romë Fiumicino. Fluturimi përfundon tre orë e njëmbëdhjetë minuta më vonë sesa koha e parashikuar e uljes. Si pasojë, Bea, në emër të saj dhe në emër të të afërmeve të saj, paraqet një kërkesë duke përdorur Formularin A ESCP pranë Gjyqtarit të Paqes në Romë, ku Alitalia ka selinë e saj, për kompensim në përputhje me Rregulloren 261/2004 për një shumë prej 250 € secili, për një total prej 1,750 €, plus interesat, tarifatat gjyqësore dhe disbursimet e tjera.

### **Skenari I:**

Supozoni se Bea ka ngritur padinë personalisht.

- **Pyetja 1:** A duhet që Gjyqtari i Paqes në Romë ta refuzojë kërkesën sepse sipas ligjit italian Bea duhet të përfaqësohet nga një avokat?

## **Rasti Studimor 6: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Skenari II:**

Supozoni se Bea nuk kërkon një seancë verbale dhe Alitalia nuk paraqet përgjigjen e saj. Gjyqtari i Paqes jep një vendim të bazuar në deklaratimet e padisë dhe në dokumentet e bashkangjitura në padi. Alitalia pastaj paraqet një ankim kundër vendimit, duke pretenduar se Gjyqtari i Paqes nuk arriti të përcaktojë rrethanat e rëndësishme për padinë dhe të vlerësojë saktë provat.

- **Pyetja 2:** A është ankimi e bazuar, si në lidhje me procedurën dhe themelin?

## **Rasti Studimor 6: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Skenari III:**

Supozoni se Bea përfaqësohet nga një avokat dhe se kërkesa e saj pranohet nga Gjyqtari i Paqes. Në vendimin e tij, Gjyqtari i Paqes i jep 75 € avokatit për shërbimin e tij, pavarësisht kërkesës për të dhënë 500 € për shërbimin e avokatit. Bea e kundërshton vendimin duke paraqitur një apel përpara Tribunalit të Romës.

- **Pyetja 3:** A është i bazuar ankimi?

## **Rasti Studimor 6: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Skenari IV:**

Supozoni se Bea përfaqësohet nga një avokat dhe se padia e saj pranohet nga Gjyqtari i Paqes. Gjyqtari i Paqes megjithatë vendos që secila palë duhet të mbulojë shpenzimet e veta gjyqësore. Bea e kundërshton vendimin duke paraqitur një apel përpara Tribunalit të Romës.

- **Pyetja 4:** A është ankimi i bazuar?

## Rasti Studimor 7: Nenet 10-19

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Faktet:**

Paola, një shtetase italiane, blen në internet dy çanta luksoze nga Rianka, një shtetas francez me vendbanim dhe vendqëndrim në Amsterdam. Sidoqoftë, pas dorëzimit, Paola kupton se ajo mori dy çanta që janë të ndryshme, dhe me vlera më të ulta, sesa ato që ajo porositi. Me ndihmën e një përkthyesi automatik në internet, Paola paraqet një kërkesë në Hollandisht duke përdorur Formularin A të Rregullores ESCP në Gjykatën e Rrethit në Amsterdam, duke pretenduar 2.000 € si diferencën midis çmimit që ajo pagoi dhe vlerës aktuale të çantave. Gjykata plotëson Pjesën I të Formularit C, e cila më pas i dorëzohet Riankës.

**Skenari I:** Supozoni se, pasi të jetë dorëzuar Formulari C së bashku me një kopje të Formularit A, Rianka refuzon të marrë dokumentet, duke treguar që të dy formularët janë shkruar në Hollandisht dhe se ajo nuk i kupton ato, pasi ajo flet vetëm frëngjisht dhe anglisht.

- **Pyetja 1:** A lejohet Rianka ta bëjë këtë? Nëse po, çfarë duhet të bëjë Gjykata e Rrethit në Amsterdam dhe/ose Rianka?

## **Rasti Studimor 7: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

**Skenari II:** Supozoni se, pasi të jetë dorëzuar Formulari C së bashku me një kopje të Formularit A, Rianka nuk paraqet një përgjigje.

- **Pyetja 2:** Çfarë duhet të bëjë Gjykata e Rrethit në Amsterdam dhe / ose Rianka?

## **Rasti Studimor 7: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Skenari III:**

Supozoni se, pas dorëzimit të Pjesës I të Formularit C së bashku me një kopje të Formularit A, Rianka plotëson Pjesën II të Formularit C. Rianka në veçanti pretendon se ajo tashmë ka paraqitur para Tribunalit të Triestes një kërkesë për një urdhër Evropian për pagesë kundër Paolës, pasi kjo e fundit nuk e paguante plotësisht çmimin e çantave.

- **Pyetja 3:** Çfarë duhet të bëjë Gjykata e Rrethit në Amsterdam?

## **Rasti Studimor 7: Nenet 10-19**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes*

### **Skenari IV:**

Supozoni se, pas dorëzimit të Pjesës I të Formularit C së bashku me një kopje të Formularit A, Rianka nuk përgjigjet dhe Gjykata e Rrethit në Amsterdam jep një vendim në favor të Paolas. Vendimi më pas i dorëzohet Riankës. Rianka paraqet një kërkesë për rishikim të vendimit brenda afatit të përcaktuar nga neni 18 (2) të Rregullores së PEPV duke argumentuar se ajo kurrë nuk i mori dokumentet e procesit gjyqësor. Rezulton që Pjesa I e Formularit C është dorëzuar nga gjykata në adresë të gabuar, për aq kohë sa paditësi nuk ka plotësuar adresën e saktë në Formularin A.

- **Pyetje 4:** A do të lejohet rishikimi?



## **Rasti studimor 8: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në Procedurën Evropiane të Kërkesëpadive të Vogla**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Maribor*

### **Fakte:**

Në fillim të vitit 2021, një konsumator slloven me emrin A bleu një televizor nga një dyqan online gjerman për 4.000 EURO. A pagoi të gjithë shumën pas dorëzimit. Sidoqoftë, televizori nuk po funksiononte si duhet. A kontaktoi dyqanin gjerman online në një përpjekje për të siguruar një rimbursim, por nuk mori asnjë përgjigje prej tyre. Për të marrë rimbursimin e shumës së paguar A plotëson " formularin A, formularin e kërkesës për procedurën evropiane të kërkesëpadive të vogla, " të paraqitur në Aneksin I të Rregullores Nr. 861/2007 dhe e paraqet atë së bashku me provat që mbështesin pretendimin në gjykatë në Slloveni.

### **Skenari I:**

Gjykata vendos që dyqani gjerman online duhet të rimbursojë konsumatorin slloven A.

- **Pyetja 1:** A lëshon gjykata automatikisht një vendim me formën e certifikatës në lidhje me një gjykim në procedurën evropiane të kërkesëpadive të vogla (formulari D)?
- **Pyetja 2:** Kur mundet A të bëjë një kërkesë për të lëshuar një certifikatë (vërtetim) në lidhje me një gjykim?

## **Rasti studimor 8: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në Procedurën Evropiane të Kërkesëpadive të Vogla**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Maribor*

- **Pyetja 3:** Në cilën gjuhë apo në cilat gjuhë të tjera të ndryshme nga ajo e procedurave gjyqësore, duhet që A të kërkojë lëshimin e certifikatës?
- **Pyetja 4:** Çfarë duhet të sigurojë A, në mënyrë që të fillojë procesi i cili mund të çojë në ekzekutimin e vendimit slloven të dhënë në procedurën evropiane të kërkesëpadive të vogla në Gjermani?
- **Pyetja 5:** A mundet që një gjykim i dhënë në Slloveni në Procedurën Evropiane të Kërkesëpadive të Vogla të rishikohet në themel në Gjermani?
- **Pyetja 6:** Në cilat rrethana një kompani gjermane mund të kundërshtojë me sukses ekzekutimin e vendimit slloven në Procedurën Evropiane të Padive të Vogla në Gjermani?

## **Rasti studimor 8: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në Procedurën Evropiane të Kërkesëpadive të Vogla**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Maribor*

### **Skenari II:**

Para ekzekutimit të vendimit të dhënë në Slloveni në Procedurën Evropiane të Padive të Vogla kompania gjermane I paguan A-së shumën e dhënë.

- **Pyetja 7:** Si mundet që kompania gjermane të kundërshtojë ekzekutimin e vendimit?

## **Rasti studimor 8: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në Procedurën Evropiane të Kërkesëpadive të Vogla**

*Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Maribor*

### **Skenari III:**

A dhe kompania gjermane përfunduan përpara një gjykate Sllovene gjatë Procedurës Evropiane të Padive të Vogla një zgjidhje me marrëveshje.

- **Pyetja 8:** A do të njihet dhe ekzekutohet në Gjermani, marrëveshja e arritur, në të njëjtat kushte siç do të ishte njohur dhe ekzekutuar vendimi nga gjykimi slloven i dhënë në Procedurën Evropiane të Padive të Vogla?

## **Rast Studimor 9: Njohja dhe ekzekutimi**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit nga Universiteti I Mariborit*

- **Fakte:**

Më 30 Janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli shpërthimin COVID-19 një 'emergjencë të shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar' dhe, më 11 Mars, 2020, e karakterizoi atë si një pandemi. Pandemia e COVID-19 ka rezultuar në ndalimin udhëtimeve kombëtare, si dhe paralajmërime ose kufizime në kufij. Kjo pasojë e rëndë ndikoi në udhëtimet ndërkombëtare dhe të brendshme, gjë që ka çuar në një numër të madh anulimesh dhe shumë qytetarë nuk kanë mundësi të udhëtojnë.

Në Shtator 2019, Maria planifikoi udhëtimin familjar në Spanjë nga 13 Mars deri më 20 Mars, 2020. Udhëtimi u organizua nga një agjenci gjermane udhëtimi, »Miracle Island,« por rezervimi u bë në agjencinë sllovene të udhëtimeve “Ëndrrat e mëdha”.

Për shkak se Sllovenia ka shpallur pandeminë më 12 Mars, Maria, si konsumatore telefoni agjencinë Sllovene, pyeti nëse udhëtimi do të ishte akoma i mundur. Agjencia u përgjigj se udhëtimi është programuar siç është planifikuar dhe nëse Maria vendos të anulojë udhëtimin në minutën e fundit, ajo nuk do të ketë të drejtën e rimbursimit të shumës së paguar për udhëtimin.

## **Rast Studimor 9: Njohja dhe ekzekutimi**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit nga Universiteti I Mariborit*

Ardhja e familjes në vendin e pushimeve përkoi me masa të rrepta të kufizimit, të cilat hynë në fuqi vetëm një ditë pas mbërritjes së tyre. Ushtria gjithashtu monitoroi pajtueshmërinë me masat.

Duke pasur parasysh se sa shpejt po përshkallëzoheshin masat, familja e re vendosi të kthehej herët si një masë paraprake. Të dy agjencitë turistike sllovene dhe gjermane e këshilluan familjen se në një moment të caktuar, është më mirë të presësh për një fluturim të rezervuar tashmë në shtëpi, pasi nuk duhet të jetë e mundur të rregullohet një kthim i menjëhershëm me një fluturim tjetër. Sidoqoftë, Maria vendos të mos e dëgjojë këtë këshillë, pasi familja u dënua në një dhomë në hotel dhe bleu biletat për t'u kthyer në Slloveni.

Lidhur me ankesën dhe kërkesën për rimbursim të kostove, Maria duhej t'i drejtohej agjencisë gjermane, e cila, në mesazhin e kthimit, u distancua nga rrethanat e paparashikuara për të cilat agjencia nuk ndihej përgjegjëse. Maria ka shpenzuar 3.325. EURO për bileta kthyesë për tre persona. Pas tre muajsh pretendimesh të pasuksesshme në postën elektronike të agjencisë Miracle Island, Maria shkarkon dhe plotëson Formularin e Kërkesës A nga seksioni i Formave Dinamike të Portalit e-Drejtësia dhe e paraqet atë në një gjykatë në Slloveni së bashku me faturën për biletat dhe shkëmbimet e-mail me agjencinë. Brenda 14 ditëve, gjykata i dërgon një kopje të formularit agjencisë, duke i dhënë asaj 30 ditë kohë për t'u përgjigjur. Agjencia përgjigjet, duke përdorur Formularin e Përgjigjes C. Gjykata urdhëron agjencinë që të rimbursojë konsumatorin dhe të rimbursojë shpenzimet ligjore dhe u jep gjykimin palëve.

## **Rast Studimor 9: Njohja dhe ekzekutimi**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit nga Universiteti I Mariborit*

- **Pyetja 1:**

A mund të ekzekutohet vendimi i lëshuar në procedurën evropiane të padive të vogla kundër agjencisë Miracle Island dhe si?

### **Skenari I:**

Agjencia gjermane Miracle Island sfidoi gjykimin në Procedurën Evropiane të Padive të Vogla nga gjykata Sllovene në Slloveni.

- **Pyetja 1:** Çfarë mundësish mund të ketë pala gjermane për të ndikuar në procedurën gjermane të ekzekutimit sepse gjykimi sfidohet në Slloveni?

# **Rasti studimor 10: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në një Procedurë Europiane të Padive të Vogla**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të Universitetit të Maribor*

## **Fakte**

Jernej, një shtetas slloven, shkoi për të vizituar miqtë e tij në Francë. Në aeroport, ai përdori shërbimet e Magic Rent, një kompani franceze e makinave me qira e vendosur në Paris. Pas pesë ditësh, ai e ktheu makinën siç ishte planifikuar në 11 të mëngjesit, por u detyrua të paguante shumë prej 485 eurosh për një të ashtuquajtur keqmenaxhim i automjetit. Jernej kundërshtoi faktet, por më pas hoqi dorë dhe pagoi shumë, pasi avioni i tij po e priste.

Kur u kthye në Slloveni, Jernej mori një telefonatë nga Magic Rent duke shpjeguar se ai do të duhet të paguante edhe 950 euro shtesë për dëmet e papara në makinë. Kompania, megjithatë, nuk ofroi ndonjë provë të dëmeve. Fatkeqësisht, Jernej u infektua me COVID-19 gjatë udhëtimit të tij dhe ishte i shtruar në spitalin e Maribor për 10 ditë.



# **Rasti studimor 10: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në një Procedurë Europiane të Padive të Vogla**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të Universitetit të Maribor*

## **Skenari I:**

Gjatë periudhës që ishte sëmurë, Jernej mori formularin C dhe D të procedurës evropiane të padive të vogla, në kutinë e tij të letrave (kutia postare).

- **Pyetja 1:** Meqenëse Jernej ishte i sëmurë dhe ishte në spital për një periudhë të gjatë, çfarë mund të bëjë ai?
- **Pyetja 2:** Cilat janë veprimet e mundshme që gjykata mund të ndërmarrë?
- **Pyetja 3:** A mundet gjykata të pezullojë ekzekutimin?

# **Rasti studimor 10: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në një Procedurë Europiane të Padive të Vogla**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të Universitetit të Maribor*

## **Skenari II**

Magic Rent 7 ditë pasi gjykata shqyrtoi vendimin, informoi Jernej me email se një kërkesë tjetër ishte në proces kundër tij për shumën prej 700 euro për neglizhencë tjetër shtesë dhe dëmtime të pariparueshme që i ishin bërë makinës.

- **Pyetja 4:** A mundet gjykata kompetente të pranojë kërkesat e Magic Rent?
- **Pyetja 5:** A mund të vendosë Magic Rent në të njëjtën kërkesë, një vend tjetër të BE që ai mendon se do të jetë më miqësor ndaj pretendimit të tij?

# **Rasti studimor 10: Njohja dhe ekzekutimi I një vendimi të dhënë në një Procedurë Europiane të Padive të Vogla**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të Universitetit të Maribor*

## **Skenari III**

Jernej, gjatë hulumtimit të tij, zbuloi manipulimet e Magic Rent dhe presionin e saj mbi klientët për të nxjerrë para prej tyre. Me prova mbështetëse, ai vendosi të sfidojë versionin Magic Rent të fakteve dhe paraqiti një kundërpadi për të kërkuar rimbursimin e 485 Euro që ai pagoi në Paris.

- **Pyetja 6:** Në rast se kërkesa e tij do të pranohet nga gjykata, a do të ketë nevojë për përfaqësues në Paris për të ekzekutuar gjykimin?
- **Pyetja 7:** Meqenëse ai nuk është me vendbanim në Francë, a do të duhet të paguajë një depozitë për ekzekutimin e vendimit të tij?

•

## **Rast studimor 11: Shitje me pakicë në internet**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të UDC*

### **Fakte:**

Amazonia.de është një kompani me pakicë në internet. Adresa e saj e regjistruar është në Berlin (Gjermani), por ofron mallra dhe shërbime për klientët në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Monetar Evropian, përmes faqes së saj të internetit, e cila është në dispozicion në disa gjuhë të ndryshme të BE-së. Andrés, një banor spanjoll në A Coruña, përdor faqen web për të blerë një kompjuter personal, një printer dhe një ekran me rezolucion të lartë, që kushtojnë përkatësisht 2499 €, 899 € dhe 995 €.

# **Rast studimor 11: Shitje me pakicë në internet**

## *Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të UDC*

### **Skenari I:**

Pas dorëzimit të tre artikujve, Andrés i teston ato për 15 ditë dhe konfirmon se ato nuk i përmbushin pritshmëritë e tij. Prandaj, ai vendos të kthejë artikujt, të anulojë pagesën e rënë dakord dhe të kërkojë që kostoja e kthimit të përballohet nga shitësi. Kompania konsideron se arsyeja e kthimit e deklaruar nga klienti nuk mbulohet nga kushtet e shitjes, të pranuar nga Andrés kur ai bleu sendet dhe synon ta padisë atë për çmimin e rënë dakord të shitjes ose, përndryshe, për kthimin e produkteve dhe kompensimin në shumën prej 30% të çmimit të përgjithshëm me pakicë, në përputhje me kushtet kontraktuale të pranuar nga Andrés, i cili përfshinte këtë dënim për refuzimin e pajustificuar të mallrave të dorëzuara.

- **Pyetja 1:** A mund ta përdorë Amazonia.de Procedurën Evropiane të Padive të Vogla për të bërë një kërkesë kundër Andrés?
- **Pyetje 2:** Në cilin Shtet Anëtarë duhet që Amazonia.de të paraqesë padinë e saj?
- **Pyetja 3:** A ka gjykata pushtet të shqyrtojë *ex officio* padrejtësitë e mundshme të kushteve të kontratës në fjalë, posaçërisht në lidhje me refuzimin e kthimit ose rimbursimin dhe klauzolën e penaltetit ndaj konsumatorit, për refuzimin e pajustificuar të mallrave të dorëzuara?

# **Rast studimor 11: Shitje me pakicë në internet**

*Pregatitur nga anëtarët e skuadrës së projektit të UDC*

## **Skenari II:**

Duke pasur parasysh rrethanat dhe problemin e kompesimit të çmimit të tregut, të artikujve nga Andrés, Amazonia.de vendos të miratojë procedurën e zakonshme të veprimit duke i caktuar këtë detyrë kompanisë së kërkimit të kredive (kompania e administrimit të mbledhjes së detyrimeve), EeRecover Inc., me seli në Spanjë .

- **Pyetja 4:** A mundet që kompania e administrimit të mbledhjes së detyrimeve të kërkojë një PEPV për të ekzekutuar detyrimin?

## **Rasti studimor 12: Anullimi I fluturimit**

*Pregatitur nga UDC anëtarët e skuadrës së projektit*

### **Faktet:**

Loreto dhe Jorge janë një çift i martuar dhe kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në Lleida. Ata blenë bileta fluturimi Ryanair, në internet për të udhëtuar nga Girona në Palma de Mallorca me synimin për të kaluar fundjavën larg. Kur mbërrin në aeroport, ata zbulojnë se fluturimi i tyre është anuluar për shkak të një ndryshimi të planifikimit të fluturimit. Kompania u ofron atyre një fluturim alternativ dy ditë më vonë, të cilin ata e refuzojnë. Ata bëjnë një kërkesëpadi për koston e fluturimeve (124 €) dhe për shpenzimet e udhëtimit: 84 € për dy bileta kthimi treni, Lleida-Girona; 230 € për netët e parapaguara në hotel, që nuk ishin në gjendje t'i përdorin; dhe 68 € për shpenzimet e jetesës.

- **Pyetja 1:** Kërkesëpadi dhe dokumentacioni mbështetës
- **Pyetja 2:** Paditë e mundshme sipas ligjit evropian dhe atij kombëtar

**Faleminderit**





*Train 2 EN4CE Project is being funded by the  
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



# Faleminderit